

# USHTRIMI I TË DREJTAVE PËRMES NDIHMËS JURIDIKE FALAS

- Broshurë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre -  
*Si dhe ku të drejtohesh për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave tua?*



**Autore:** Bojana Jovanovska,  
Ina Xhugumanova,  
Natasha Petkovska  
**Përkthyes:** Elizabeta Poljoska

CIP - Каталогизација во публикација  
Nационална и univerzitetaska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

342.7-056.26/.36(497.7)(035)  
347.921.8-056.26/.36(497.7)(035)

JOVANOVSKA, Bojana

Ushtrimi i të drejtave përmes ndihmës juridike falas : broshurë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre : si dhe ku të drejtohesh për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave tua? / [autore Bojana Jovanovska, Ina Xhugumanova, Natasha Petkovska ; përkthyes Elizabeta Poljoska ]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, 2020. - 40 стр. : илустр. ; 21 см

Финансиер: Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, Forcimi Ligjor në Komunitetin në Procesin e Deinstitutionalizimit

ISBN 978-608-4790-69-3

1. Xhugumanova, Ina [автор] 2. Petkovska, Natasha [автор]

а) Права на лица со попреченост -- Македонија -- Прирачници б) Лица со попреченост -- Бесплатна правна помош -- Македонија -- Прирачници  
COBISS.MK-ID 51586565



British Embassy  
Skopje



Ky produkt është përgatitur në kuadër të programit „Bazat për të ardhmen“ i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose qëndrimet e Qeverisë britanike dhe UNICEF.

Kjo broshurë është prodhuar si pjesë e projektit “Forcimi Ligjor në Komunitetin në Procesin e Deinstitutionalizimit” të cilin Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, me mbështetjen e UNICEF, filloi ta zbatojë në gusht 2019. Qëllimi kryesor është t’u ofrojë ndihmë dhe mbështetje fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në ushtrimin e të drejtave bazike të njeriut, nga njëra anë, si dhe mbështetje atyre që janë përgjegjës për ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë juridike, nga ana tjetër.

Në këtë broshurë do të gjeni përgjigje për disa nga pyetjet më të shpeshta në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Për të gjitha pyetjet për të cilat nuk do të gjeni përgjigje në këtë broshurë, mund të kontaktoni drejtpërdrejtë me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Kontaktet e organizatave dhe institucioneve përkatëse mund t’i gjeni në fund të kësaj broshure.

Për të gjitha pyetjet shtese mund të drejtoheni në:

**Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**  
**rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup**  
**+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436**  
**helkom@mhc.org.mk**

# Përmbajtja

<b>JURIDIKE FALAS</b> .....	6
ÇFARË DO TË THOTË NDIHMA JURIDIKE FALAS? .....	6
NDIHMA JURIDIKE PARËSORE .....	7
Ku të drejtohesh nëse ke nevojë për ndihmë juridike parësore? .....	8
NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE .....	9
Cilat kushte duhet t'i plotësosh për të marrë ndihmë juridike dytësore? .....	9
Kushtet në lidhje me të ardhurat .....	10
Kushtet në lidhje me pronën .....	11
Në cilat raste mund të marrësh ndihmë juridike dytësore pa përcakim të gjendjes tënde financiare? .....	11
Procedura për marrjen e ndihmës juridike dytësore .....	12
Në cilën procedurë mund të refuzohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore? ..	13
Çfarë ndodh nëse procedura dështon? .....	14
<b>DISKRIMINIMI</b> .....	15
Diskriminim i drejtpërdrejtë .....	16
Diskriminim i tërthortë .....	17
Si të mbrohesh nga diskriminimi? .....	19
Procedura para Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. .	19
Procedura para avokatit të popullit .....	19
Procedurë gjyqësore .....	19
<b>MBROJTJA SOCIALE</b> .....	21
Ndryshimet në ligjin e ri për mbrojtjen sociale .....	21
Kompensimi i parave nga mbrojtja sociale .....	22

Ndihma minimale e garantuar . . . . .	22
Kompensimi për shkak të aftësisë së kufizuar . . . . .	23
E drejta e kompensimit për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër . . . . .	25
Kompensimi për punë me kohë të pjesshme . . . . .	26
E drejta për kompensim të përhershëm . . . . .	27
Kompensime për personat me aftësi të kufizuara nën moshën 26 vjeç . . . . .	27
Shërbime sociale në shtëpi . . . . .	28
Cilat shërbime mund t'i përdorësh në shtëpi? . . . . .	28
Cilat janë shërbimet sociale në komunitetin? . . . . .	30
<b>ARSIMI</b> . . . . .	31
Ndryshimet në Ligjin për arsimin fillor . . . . .	31
Cilët janë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore? . . . . .	32
Adaptimi i arsyeshëm në arsimin . . . . .	32
<b>MARRËDHËNIET NË PUNË</b> . . . . .	35
Ku mund të raportoni diskriminim dhe shkelje të të drejtave . . . . .	37
Zyrat rajonale dhe personat e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë . . . . .	38



## NDIHMË JURIDIKE FALAS

### ÇFARË DO TË THOTË NDIHMJA JURIDIKE FALAS?

---

Ndihma juridike falas është ndihma juridike që miratohet dhe financohet nga shteti në mënyrë dhe në kushte të parashikuara me Ligjin për Ndhimë Juridike Falas. Quhet falas sepse ti si përdorues/e nuk paguan për shërbimin, dhe fondet për miratimin e ndihmës juridike falas dhe shpenzimet për ndihmën juridike që jepet sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, donacionet dhe të ardhurat e tjera në përputhje me ligjin.

Ti ke të drejtë për ndihmë juridike falas nëse ke vendbanim ose qëndron në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE

Nëse ke nevojë për informacion mbi ushtrimin e të drejtave të tua dhe/ose përballesh me një çështje juridike që kërkon këshilla dhe udhëzime juridike, mund të marrësh **ndihmë juridike parësore** në formën e:

**Informacionit të përgjithshëm juridik** - udhëzime dhe informacione të përgjithshme dhe parimore mbi mënyrën, kushtet dhe procedurën e ushtrimit të disa të drejtave ose interesave të tua, përbushjen e një detyrimi specifik dhe referimin tek një organ publik kompetent ose gjykatë kompetente.

*Nëse të intereson se cilat janë kompensimet që mund t'i gëzojnë personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, ti ke nevojë për ndihmë juridike parësore në formën e **informacionit juridik**.*

**Këshillit të përgjithshëm juridik** - këshilla për mënyrën dhe mundësitë për zgjidhjen e çështjes tënde ligjore, legjislacionin, mundësinë e zgjidhjes jashtë gjykatës, rregullat dhe kostot e procedurës, ekzekutimin e vendimeve të procedurës, njoftimin me të drejtat dhe detyrimet e tua, si dhe mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike në proceset gjyqësore dhe administrative.

*Nëse Qendra për Punë Sociale sjell vendim me të cilin e refuzon kërkesën tënde për kompensim për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër, ti ke nevojë për ndihmë juridike parësore në formën e **këshillit juridik** për ankese ndaj vendimit.*

Me ndihmën juridike parësore, ti gjithashtu mund të marrësh ndihmë për **plotësimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, plotësimin e formularëve dhe aplikacioneve dhe përpilimin e ankesave në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, avokatin e popullit dhe Gjykatën Kushtetuese.**

## **Ku të drejtohesh nëse ke nevojë për ndihmë juridike parësore?**

Nëse ke nevojë për ndihmë juridike parësore, mund ta kontaktosh Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, si një shoqatë e autorizuar për ndihmë juridike falas.

**Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**  
rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup  
+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436  
[helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

Ndihmë juridike parësore gjithashtu mund të kërkosh edhe nga:

---

### **Personat e autorizuar në departamentet rajonale të Ministrisë së Drejtësisë.**

*Të gjitha adresat dhe numrat e telefonit të zyrave rajonale mund t'i gjesh në fund të kësaj broshure.*

---

---

### **Klinikat juridike të fakulteteve juridike në Shkup, Shtip dhe Tetovë**

*Klinikat juridike janë njësi organizative të fakulteteve juridike dhe qëllimi kryesor i tyre është t'i afrojnë studentët me realitetin e përditshëm të profesionit juridik. Listën e klinikave juridike mund ta gjesh në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë*  
**<https://www.pravda.gov.mk/clinics>**

---

---

### **Shoqatat e tjera të regjistruara në Regjistrin e Shoqatave të autorizuar për të ofruar ndihmë juridike parësore**

*Listën e shoqatave mund ta gjesh në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë*  
**<http://www.pravda.gov.mk/bpp>**

---



## NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Nëse ke nevojë për ndihmë juridike profesionale nga një avokat për një punë specifike juridike dhe për shkak të situatës tënde financiare nuk je në gjendje t'i paguash shpenzimet e procedurës, mund të përdorësh ndihmë juridike dytësore falas.

Ndihma juridike dytësore sigurohet nga një avokat i regjistruar në Regjistrin e avokatëve të ndihmës juridike dytësore. Lista e avokatëve mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë: <http://www.pravda.gov.mk/bp-advokati>

Mund të kërkohsh ndihmë juridike dytësore nëse je:

- qytetar i vendit tonë ose ke vendbanim të përhershëm në të,
- shtetas i huaj me lejë qëndrimi të përkohshme ose të përhershme në vendin,
- person pa shtetësi që banon ligjërisht në vendin,
- person që ka të drejtë të ndihmës juridike në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë,
- azilkërkues.

### Cilat kushte duhet t'i plotësosh për të marrë ndihmë juridike dytësore?

Nëse je duke kërkuar ndihmë juridike dytësore, duhet të plotësosh disa kushte në lidhje me të ardhurat e tua dhe pronën që e ke në dispozicion.

## Kushtet në lidhje me të ardhurat

Nëse jeton vetë, të ardhurat e tua mujore nuk duhet ta tejkalojnë pagën minimale neto.

Nëse jeton vetëm, të ardhurat e tua mujore nuk duhet ta tejkalojnë shumën prej **14.500,00 denarë.**

Nëse jeton në një familje bashkë me disa njerëz, të ardhurat e tua mujore nuk duhet ta tejkalojnë pagën minimale neto, dhe të ardhurat mujore të secilit anëtar vijues i familjes nuk duhet të tejkalojnë 20% të pagës minimale.

Nëse jeton në një familje bashkë me një anëtar tjetër, të ardhurat e tua totale mujore nuk duhet ta tejkalojnë shumën prej **17.400,00 denarë.**

Nëse jeton në një familje bashkë me edhe dy anëtarë të tjerë, të ardhurat e tua totale mujore nuk duhet ta tejkalojnë shumën prej **20.300,00 denarë.**

## Kushtet në lidhje me pronën:

Ti dhe anëtarët e familjes tënde të keni në pronësi vetëm një apartament njëdhomësh ose apartament që është një pjesë e veçantë e ndërtesës në të cilën jetoni.



Ti dhe anëtarët e familjes tënde të keni në pronësi një ose më shumë parcela kadastrale të lidhura fizikisht me një sipërfaqe totale jo më e madhe se 300 m<sup>2</sup> në qytetin e Shkupit ose 500m<sup>2</sup> në komunat në vend, pra një ose më shumë parcela kadastrale me sipërfaqe totale jo më e madhe se 5000 m<sup>2</sup> në zonat rurale.



Ti dhe anëtarët e familjes tënde posedoni vetëm një automjet motorik të regjistruar, me kapacitet të motorit i cili nuk tejkalon 1200 centimetra kub



## Në cilat raste mund të marrësh ndihmë juridike dytësore pa përcakim të gjendjes tënde financiare?

Mund të marrësh ndihmë dytësore juridike pa përcakim të gjendjes tënde financiare nëse:

- Je i/e vendosur në një familje kujdestare, një njësi banimi për jetesë të organizuar me mbështetje ose në një institucion për mbrojtje sociale, me vendim të Qendrës për Punë Sociale.
- Ke nevojë për inicim dhe përfaqësim në një procedurë për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje para një gjykate kompetente.
- Për shkak të katastrofës natyrore, forcës madhore ose rrethanave të tjera përtej kontrollit tënd, gjendesh në një situatë financiare që të pengon ta sigurosh mbrojtjen e të drejtave të tua.

*Në dy rastet e fundit, duhet ta sigurosh dokumentacionin shtesë për gjendjen tënde.*

## Procedura për marrjen e ndihmës juridike dytësore

Procedura për marrjen e ndihmës juridike dytësore fillon në momentin kur paraqet një kërkesë për ndihmë juridike dytësore në zyrën rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ndodhet në zonën e vendbanimit ose qëndrimit tënd.

Kërkesën mund ta paraqesësh personalisht, me postë ose përmes një shoqate të autorizuar.

Për secilën çështje juridike të veçantë për të cilën dëshiron të fillosh një procedurë, duhet të plotësosh dhe paraqesësh një kërkesë të veçantë për ndihmë juridike dytësore.

Nëse aprovohet ndihma juridike dytësore, atëherë:

- Autorizohet avokati i caktuar për sigurimin e ndihmës juridike dytësore
- Do të lirohesh nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe nga shpenzimeve në lidhje me procedurën gjyqësore
- Do të lirohesh nga pagesa e tarifave administrative
- Do të lirohesh nga shpenzimet për ekspertizën

### Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

është shoqatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike falas. Nëse ke nevojë për më shumë informacion në lidhje me procedurën e ndihmës juridike dytësore, mund të drejtohesh në departamentin tonë juridik. Ne gjithashtu mund të të ndihmojmë ta plotësosh kërkesën tënde për ndihmë juridike dytësore. Kërkesa gjithashtu mund të paraqitet përmes nesh.

### Adresa jonë ëshë

rr. Naum Naumovski Borçe  
nr. 83, 1000 Shkup

### Mund të na kontaktosh edhe në numrat e telefonit

+389 (0) 2 3119 073;  
+389 (0) 72 278 436  
ose me email  
helkom@mhc.org.mk

## Në cilën procedurë mund të refuzohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore?

### ■ Çështje doganore dhe tatimore

*Nëse nuk e paguan tatimin mbi të ardhurat personale, Zyra e të Ardhurave Publike do të fillojë procedurë kundër teje për mbledhjen e detyrueshme të borxhit. Në këtë rast, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë juridike dytësore.*

### ■ Sharje dhe fyerje

*Nëse një njohës/e i/e juaj të shan në rrjetin social "Facebook", ose deklaron informacion të pavërtetë për ty dhe kështu e dëmton nderin dhe reputacionin tënd, nuk ke të drejtë të ndihmës juridike falas për të ngritur padi kundër këtij personi.*

### ■ Kompensim për dëmin jopasuror, përveç në rastet e viktimave të veprave penale, si dhe në rast të vdekjes ose shkakimit të rëndë të aftësisë së kufizuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Detyrimet

*Nëse një person në mënyrë të paautorizuar e merr fotografinë tënde dhe e poston atë në një portal në Internet, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë juridike dytësore falas për të ngritur padi kundër këtij personi për shpërblimin e dëmit jopasuror për shkeljen e të drejtës së autorit.*

### ■ Shërbime publike dhe komunale

*Nëse përballësh me një problem në lidhje me sistemin e kanalizimit në oborr dhe do ta padisësh institucionin përgjegjës, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë juridike dytësore.*

### ■ Çështje të pronësisë në procedurat administrative

*Nëse ke nevojë të aplikosh për përcaktimin e statusit juridik të një objekti të paligjshëm, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë juridike dytësore.*

### ■ Shkelje

*Nëse kundër teje është ngritur një procedurë kundërvajtëse para një gjykate kompetente për shkelje në trafik, nuk ke të drejtë të marrësh ndihmë juridike dytësore.*

## Çfarë ndodh nëse procedura dështon?

Nëse dështon në procedurën për të cilën të është miratuar ndihma juridike dytësore, detyrimi yt do të jetë t'i paguash shpenzimet e bëra. Prandaj, para se ta paraqesësh kërkesën për ndihmë juridike dytësore, është e nevojshme të konsultohesh me një avokat, i cili do të t'i prezantojë shanset reale për suksesin e procedurës. Për më tepër, kur zyrat rajonale vendosin nëse do ta aprovojnë kërkesën tënde, ata do t'i marrin në konsideratë të gjitha rrethanat që lidhen me përfundimin e procedurave në favorin tënd, dhe nëse ekziston një probabilitet i lartë i dështimit të procedurës, ata do ta refuzojnë kërkesën tënde për ndihmë juridike dytësore.

---

**Nëse nuk je i/e të sigurt a të kërkosh ndihmë juridike dytësore sepse nuk je i/e sigurt për rezultatin e procedurës tënde, mund të kërkosh këshilla juridike nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.**

---



## DISKRIMINIMI

Diskriminimi është çdo **dallim, përjashtim, kufizim** ose **kushtim i përparësisë** bazuar në baza diskriminuuese, duke vepruar ose mos vepruar, me qëllim të **parandalimit, kufizimit, njohjes, gëzimit ose ushtrimit të të drejtave dhe lirive të një personi ose grupi të caktuar** mbi një bazë të barabartë me te tjerët.

**Bazat e diskriminimit** mund të jenë raca, ngjyra e lëkurës, kombësia ose përkatësia etnike, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia e grupeve të marginalizuara, gjuha, shtetësia, origjina sociale, arsimi, feja ose besimi fetar, bindjet politike, bindje të tjera, **AFTËSITË E KUFIZUARA**, mosha, statusi familiar ose martesor, statusi i pasurisë, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror ose çfarëdo baze tjetër.

Të jesh viktimë e diskriminimit nuk do të thotë që në mënyrë të drejtpërdrejtë të posedosh një nga bazat e lartpërmendura. **Ndalimi i diskriminimit nuk është i kufizuar vetëm tek personat me aftësi të kufizuara, por i përfshin edhe personat e prekur nga gjendja e tyre, përkatësisht anëtarët e familjes, kujdestarët dhe personat e tjerë që kujdesen për persona me aftësi të kufizuara.**

## Diskriminim i drejtpërdrejtë

Ti je i/e **diskriminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë** kur dikush të trajton më pak favorshëm se një person ose grup tjetër, në një situatë faktike ose të mundshme të krahasueshme ose të ngjashme.

Pas një aksidenti trafiku pothuajse fatal, Marias iu amputuan të dyja këmbët. Për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, një mjek specialist i rekomandoi rehabilitim mjekësor në pishinë në IPSH Institutin për Mjekësi Fizike dhe Rehabilitim ose në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori". Për shkak të faktit se vinçat për përdorimin e pishinave në këto institucione shëndetësore nuk funksionojnë, ajo u detyrua të rehabilitohet në Katlanovska Banja. Referimi i Marias për rehabilitim jashtë komunitetit ku jeton përfaqëson edhe një pengesë më tepër për funksionimin e saj tashmë i ndërlikuar dhe i vështirë i përditshëm, dhe në të njëjtën kohë është edhe një shpenzim shtesë financiar për të.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë, në të njëjtën mënyrë si të gjithë të tjerët, t'i përdorin shërbimet shëndetësore, në këtë rast mundësinë e rehabilitimit në një pishinë në objektet e shëndetit publik. Parandalimi i personave me aftësi të kufizuara të përdorin pishina rehabilitimi në një pozitë të barabartë me të tjerët është diskriminim i drejtpërdrejtë.



## Diskriminim i tërthortë

Kur përmes rregulloreve, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave që në dukje janë neutrale, ti je i/e vendosur në një pozitë më pak të favorshme në krahasim me persona ose një grup njerëzish të tjerë, ti **diskriminohesh në mënyrë të tërthortë**, përveç nëse kjo buron nga një qëllim legjitim dhe mjetet për ta arritur atë qëllim janë proporcional, domethënë, të përshtatshëm dhe të nevojshëm.

*Restoranti "Restorantko" publikoi një shpallje për punësim të një kuzhinieri kryesor. Sipas kushteve të shpalljes, kandidati, ndër të tjerat, duhet të ketë patentë shoferi. Kjo shpallje pune i vendos në një pozitë më pak të favorshme disa nga personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të marrin patentë shoferi. Kjo shpallje nuk mund të justifikohet me objektivitet, sepse detyrat për punën kuzhinier kryesor nuk kërkojnë që punonjësi të drejtojë një automjet nga një destinacion në një tjetër. Ky kusht i veçantë mund të justifikohet objektivisht nëse, për shembull, bëhet fjalë për një furnizues.*

*Prandaj, shpallja e publikuar për punë për "Restorantko" quhet **diskriminim i tërthortë në bazë të aftësisë së kufizuar**.*

Askush nuk guxon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të **tërthortë të inicojë, inkurajojë, jep udhëzime ose nxisë** që dikush të të diskriminojë në çfarëdo bazë.

Çdo trajtim i padëshirueshëm ndaj teje në bazë të diskriminimit, i cili ka për qëllim ose pasojë ta shkelë dinjitetin tënd ose të krijojë një mjedis, qasje ose praktikë kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese, quhet **ngacmim**.

**Segregacioni** ekziston sa herë që dikush të veçon fizikisht në bazë diskriminuese, pa një qëllim të ligjshëm ose të justifikuar objektivisht.

## Të gjitha këto forma quhen diskriminim dhe janë të ndaluara.

Ndalimi i diskriminimit i përfshin të gjitha format e diskriminimit, përfshirë dhe çmundësimin e adaptimit të përshtatshëm dhe çmundësimin e aksesit dhe disponueshmërinë e infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve.

### **Akomodimi i përshtatshëm**

është ndryshimi dhe akomodimi i përshtatshëm që nuk shkakton barrë disproporcionale dhe të papërshtatshme, dhe bëhet me qëllim që të sigurohet që t'i gëzosh dhe ushtrosh të drejtat bazike të njeriut në bazë të barabartë me të tjerët.

**Qasja në infrastrukturë, mallra dhe shërbime** do të thotë që të gjithë palët përbërëse në shoqëri e kanë për detyrim të ndër marrin veprime të duhura që do të mundësojnë qasje në bazë të barabartë me të tjerët, në mjedisin fizik, transportin, informacionin dhe komunikimin, përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, deri në objekte dhe shërbime të tjera publike në zonat urbane dhe rurale.

### **AKOMODIMI I PËRSHTATSHËM**

Ida është një fëmijë me aftësi të kufizuara fizike, e cila përdor një karrocë me rrota për t'i ndjekur mësimet e rregullta të shkollës fillore, ku është në klasën e pestë. Klasat mbahen në katin e dytë të ndërtesës, e cila nuk ka ashensor, kështu që prindërit e saj detyrohen ta çojnë fëmijën e tyre në klasë me duar nëpër shkallët. Prindërit kanë kërkuar nga shkolla që ta zhvendosin klasën në katin përdhësë. Kërkesa e tyre është refuzuar me arsyetimin se klasa ku ndodhet Ida e ka numrin më të madh të fëmijëve në shkollë, dhe klasa në katin e dytë është më e përshtatshme sepse është më e madhja.

Shkolla e ka për detyrë të akomodohet në mënyrë të përshtatshme ndaj nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata t'i gëzojnë të drejtat dhe interesat e tyre në bazë të barabartë me të tjerët. Çmundësimi i përshtatjes së duhur quhet diskriminim.

## Si të mbrohesh nga diskriminimi?

### **Procedura para Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Nëse e konsideron veten viktimë të diskriminimit, mund të paraqesësh një ankesë pranë Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ankesën mund ta paraqesësh në internet në faqen e internetit të Komisionit ose me shkrim në adresën e Komisionit. Ankesën duhet ta paraqesësh jo më vonë se **6 muaj** pas informimit për aktin e diskriminimit, dhe jo më vonë se **1 vit** nga koha e kryerjes së shkeljes. Komisioni duhet të marrë vendim brenda 60 ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës.

### **Procedura para avokatit të popullit**

Ti gjithashtu mund të paraqesësh një ankesë tek avokati i popullit. Në atë rast, ankesën e paraqet me shkrim (personalisht ose me postë), gojarisht në procesverbal në ambientet e avokatit të popullit, me telefon ose me postë elektronike.

### **Procedurë gjyqësore**

Ti gjithashtu mund të paraqesësh padi në gjykatën civile kompetente, me të cilën mund të kërkosësh që gjykata të vendosë shkelje të të drejtës për trajtim të barabartë, t'i ndalojë kryerësit të diskriminimit të ndër-marrë veprime, të kërkojë dëmshpërblim ose të botojë aktgjykimin në media.

## **NËSE E KONSIDERON VETEN VIKTIMË TË DISKRIMINIMIT**

Denonco në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Si shoqatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore, ne do të të ndihmojmë në përpilimin e ankesave pranë Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe avokatit të popullit. Në të njëjtën kohë, Komiteti mund të paraqesë një ankesë për të dy këta mekanizma mbrojtës në emrin tënd.

**Adresa jonë është  
rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83,  
1000 Shkup**

**Mund të na kontaktosh edhe përmes numrat e telefonit  
+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436  
ose me email  
helkom@mhc.org.mk**



## MBROJTJA SOCIALE

### Ndryshimet në ligjin e ri për mbrojtjen sociale

Ligji për Mbrojtjen Sociale, i cili u miratua në maj të vitit 2019, paraqiti të drejta dhe kushte plotësisht të reja për përdorimin e tyre, si dhe rrimërim të disa nga të drejtat e paraqitura më parë. Ligji gjithashtu e përfshin ndalimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze, përfshirë aftësinë e kufizuar, në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale të përcaktuara me këtë ligj.

### NËSE KE NEVOJË PËR NDIHMË LIGJORE

për t'i plotësuar kërkesat që duhet t'i paraqesësh për të realizuar ndonjë nga kompensimet e deklaruara nga mbrojtja sociale, ose nëse ke nevojë për ndihmë gjatë përpilimit të një ankese kundër vendimeve me të cilën të është mohuar e drejta, mund ta kontaktosh

në

rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup

Mund të na kontaktosh edhe në numrat e telefonit

**+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436**

ose me email

**helkom@mhc.org.mk**

# Kompensimi i parave nga mbrojtja sociale

## Ndihma minimale e garantuar

*Nëse jeton në një familje që është materialisht e pasiguruar dhe nuk ka në posedim pronë dhe të drejtë të pronësisë në të cilat mund të mbështetet, ti ke të drejtë për ndihmë minimale të garantuar.*

Quhet që ti jeton në një familje **të pasiguruar materialisht** nëse në tre muajt e mëparshëm para paraqitjes së kërkesës për realizimin e të drejtës, të ardhurat totale të të gjithë anëtarëve të familjes kanë qenë më pak se shuma e ndihmës minimale e garantuar. Ky rregull vlen gjithashtu për tërë kohëzgjatjen e përdorimit të kësaj të drejte nga ana jote

**Baza** e llogaritjes së sasisë së ndihmës **është 4,000 denarë në muaj**, dhe për secilin anëtar të rritur të mëpasshëm të familjes (deri në maksimum pesë anëtarë në familje) baza rritet sipas një shkalle ekuivalente. Shkalla ekuivalente rritet për një person i cili nuk është në gjendje të punojë për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale, aftësisë së kufizuar fizike, sëmundjes mendore ose për shkak të ndryshimeve të përhershme në shëndet, por deri në tre anëtarë në familje.

Numri i anëtarëve në familje	Shuma e të ardhurave mesatare mujore për realizimin dhe përdorimin e së drejtës së ndihmës minimale të garantuar
<b>1</b>	<b>4.000 denarë</b>
<b>2 të ritur</b>	<b>6.000 denarë</b>
<b>2</b> (1 prind i vetëm dhe 1 fëmijë)	<b>6.400 denarë</b>
<b>3 të ritur</b>	<b>7.600 denarë</b>
<b>3</b> (2 prind i vetëm dhe 1 fëmijë)	<b>6.400 denarë</b>
<b>4</b> (2 prind i vetëm dhe 2 fëmijë)	<b>6.800 denarë</b>
<b>4</b> (2 prind i vetëm, 1 fëmijë dhe 1 i ritur)	<b>8.000 denarë</b>
<b>5</b> (2 prind i vetëm dhe 3 fëmijë)	<b>7.200 denarë</b>
<b>5</b> (4 prind i vetëm dhe 1 fëmijë)	<b>9.600 denarë</b>
<b>5 të ritur</b>	<b>10.000 denarë</b>

\*Tabela e të ardhurave mesatare mujore të disa llojeve të familjeve për realizimin dhe përdorimin e të drejtës së ndihmës minimale të garantuar.

## Kompensimi për shkak të aftësisë së kufizuar

**Kompensimi për aftësi të kufizuar të takon nëse je person:**

- me aftësi të kufizuar intelektuale të rëndë ose të thellë,
- me aftësi të kufizuar fizike më të rëndë,
- person plotësisht i verbër dhe
- person plotësisht i shurdhër.

**Shuma** e ndihmës mujore për shkak të aftësisë së kufizuar është **4,117 denarë** për një person plotësisht të shurdhër dhe **7.204 denarë në rastet e tjera të listuara.**

Kjo tarifë vlen vetëm nëse je nga **26 vjeç** dhe deri **65 vjeç**. Nëse je në moshën ndër **26 vjeç**, të takon një ndihmë e veçantë për fëmijë me nevoja të veçanta që është me aftësi të kufizuara në zhvillimin fizik ose mendor ose një kombinim të aftësive

të kufizuara në zhvillimin. Nëse je **mbi 65 vjeç**, do të kesh të drejtë për kompensimet e parashikuara në Ligjin për Sigurinë Sociale të të moshuarve.

## Kjo e drejtë nuk të takon nëse je i/e vendosur për më shumë se 30 ditë në:

- institucion për mbrojtje të jashtëzakonshme sociale (si për shembull shtëpi për një grup të vogël),
- familje kujdestare,
- në një vendbanim të organizuar me mbështetje (persona që jetojnë në njësi të veçanta strehimi me ndihmë të përhershme ose të përkohshme nga profesionistë) ose
- në një institucion shëndetësor ose institucion tjetër gjatë periudhës së zgjatës së akomodimit.

Të drejtën e kompensimit të aftësisë së kufizuar mund ta realizosh **në bazë të një opinionit konsullor nga një komision i shkallës së parë**. Nëse nuk je i/e kënaqur me opinionin konsullor të dhënë nga komisioni i shkallës së parë, ti ke të drejtë të ankohesh në **komisionin e shkallës së dytë** i cili përbëhet gjithashtu nga tre mjekë specialistë nga një institucion përkatës shëndetësor terciar, i ndryshëm nga ata që e kanë miratuar opinionin konsullor të shkallës së parë

---

**Opinionit konsullor** është një konstatim, vlerësim dhe opinion për shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar të personit, dhe kryhet nga një **komision i shkallës së parë** i përbërë nga tre mjekë specialistë nga një institucion shëndetësor terciar (klinika universitare, instituti universitar dhe qendra klinike universitare).

---



## KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Nëse ke nevojë për ndihmë juridike në përpilimin e ankesës,  
mund të na gjesh në adresën e mëposhtme

**rr. Naum Naumovski Borçe nr. 83, 1000 Shkup**

ose të na kontaktosh në

**+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436 dhe  
helkom@mhc.org.mk**

### E drejta e kompensimit për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër

Nëse je person **26 vjeç** dhe ke aftësi të kufizuar intelektuale të moderuar, të rëndë ose të thellë, je person me aftësi të kufizuara fizike të rëndë dhe shumë të rëndë, person plotësisht i/e verbër dhe person me ndryshime të përhershme shëndetësore dhe ke nevojë për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër sepse nuk mundesh vetë t'i kryesh aktivitetet bazike të jetës së përditshme, ti ke të drejtë për **kompensim për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër**.

**TI KE NEVOJË PËR NDIHMË DHE KUJDES NGA NJË PERSON TJETËR DHE NËSE JE PERSON I CILI PËR SHKAK TË NDRYSHIMEVE TË PËRKOHSHME NË SHËNDETIN, PA NDIHMËN E PAJISJEVE ORTOPEDIKE NUK MUND T'I KRYESH AKTIVITETET BAZIKE TË JETËS SË PËRDITSHME.**

**Shuma** e kompensimit për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër përcaktohet **në varësi të shkallës së nevojës që e ke për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër.**

## **Kompensimi i shkallës më të madhe është 4,475 denarë**

**Kompensimin e shkallës më të madhe** mund ta përdorësh nëse je person me aftësi të kufizuar intelektuale të rëndë ose shumë të rëndë, person me aftësi të

kufizuar fizike të rëndë dhe shumë të rëndë, person plotësisht i/e verbër, si dhe person me ndryshime të përhershme shëndetësore, për shkak të cilave nuk mundesh vetë t'i kryesh aktivitetet bazike të jetës së përditshme, dhe me ndihmën e pajisjeve ortopedike nuk mund të lëvizësh vetë nëpër apartament ose jashtë apartamentit, vetë të ushqehesh, vishesh, mbash higjenën personale vetë ose kryesh nevojat bazike fiziologjike.

Ti ke të drejtë për kompensimin e shkallës më të vogël nëse je person me aftësi të kufizuar intelektuale të moderuar dhe nëse je person i cili për shkak të ndryshimeve të përhershme në shëndetin nuk mundesh t'i përmbushësh plotësisht nevojat bazike të jetës pa ndihmën e një personi tjetër.

## **Kompensimi i shkallës më të vogël është 3.959 denarë**

### **Kompensimi për punë me kohë të pjesshme**

**Si prind i një fëmije me aftësi të kufizuara dhe format më të rënda të sëmundjeve kronike, ti ke të drejtë për një pagë për punë me kohë të pjesshme, e cila realizohet në qendrën e mbrojtjes sociale, pavarësisht nga mosha e fëmijës, që do të thotë dhe pasi fëmija bëhet 18 vjeç.**

---

Shuma e kompensimit të pagës është **50% e pagës mesatare neto për punë me orar të plotë** të paguar në vitin e kaluar, që do të thotë **100% e pagës mesatare neto për punë me kohë të pjesshme.**

## E drejta për kompensim të përhershëm

Nëse je grua mbi 62 vjeç ose burrë 64-vjeç, nuk je i/e punësuar ose nuk ke të drejtë pensioni, dhe je kujdesur për një person me aftësi të kufizuara

**Shuma e kompensimit të përhershëm është 8.000 denarë në muaj.**

në familjen tënde për të paktën 15 vjet ose je prind që kujdeset për një fëmijë me aftësi të kufizuara deri në moshën 26 vjeç (pa e përdorur shërbimin e mbrojtjes sociale jashtë familjes, siç është vendosja e fëmijes në një shtëpi për grup të vogël), ti ke të drejtë për **kompensim të përhershëm**.

## Kompensime për personat me aftësi të kufizuara nën moshën 26 vjeç

**Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve** parashikon një kompensim të veçantë me para. i quajtur **ndihmë e veçantë** dhe parashikohet për një fëmijë me nevoja specifike me aftësi të kufizuara në zhvillimin fizik ose mendor ose një kombinim të aftësive të kufizuara të zhvillimit deri në moshën 26 vjeç.

Shuma rritet me 50% dhe arrin deri në 7,531 denarë nëse je prind i vetëm që ka një fëmijë me nevoja specifike i cili ka aftësi të kufizuara në

**Shuma e ndihmës së veçantë është 5.021 denarë.**

zhvillimin fizik ose mendor ose një kombinim të aftësive të kufizuara të zhvillimit deri në moshën 26 vjeç. Shuma rritet me 25% dhe arrin deri në 6,276 denarë nëse je prind materialisht i/e pasiguar, që përdor ndihmë minimale të garantuar, ke një fëmijë me nevoja specifike me aftësi të kufizuara në zhvillimin fizik ose mendor ose një kombinim të aftësive të kufizuara deri në moshën 26 vjeç.

***Nëse i plotëson kushtet, ti mund ta ushtrosh këtë të drejtë duke paraqitur një kërkesë në Qendrën për Punë Sociale sipas vendit ku banon.***

## Shërbime sociale në shtëpi

*Shërbimet në shtëpi janë shërbime për sigurimin e ndihmës dhe kujdesit në shtëpinë e një personi me aftësi funksionale të zvogëluara të përkohshme ose të përhershme, me qëllim që t'i mundësohet personit të vazhdojë të jetojë në shtëpinë e vet dhe të mos ketë nevojë për kujdes urgjent jashtë familjes.*

### Cilat shërbime mund t'i përdorësh në shtëpi?

Ekzistojnë dy lloje të shërbimeve në shtëpi: **ndihma dhe kujdesi në shtëpi dhe asistenca personale.**

### NDIHMA DHE KUJDESI NË SHTËPI

Ky shërbim ofron ndihmë në kryerjen e veprimtarive bazike dhe instrumentale të jetës së përditshme deri në 80 orë në muaj, për njerëzit me aftësi funksionale të zvogëluar të cilët nuk mundën të kujdesen për veten e tyre, me qëllim që të aftësohet përdoruesi për vetë-ndihmë, që do të thotë ta rikthejë, përvetësojë ose mirëmbajë aftësinë për t'u kujdesur për veten, për të vazhduar të jetojnë në shtëpinë e vet dhe për të jetuar një jetë të pavarur në komunitetin.

**Përdorues të shërbimit** janë njerëz me aftësi të kufizuara më të rënda, që do të thotë aftësi të kufizuara të kombinuara të shkallës më të lartë, njerëz plotësisht të verbër, njerëz të moshuar dhe njerëz të tjerë që kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes në shtëpi.

Këtë shërbim mund ta përdorin fëmijët me aftësi të kufizuara, nëse ju si prindër nuk jeni në gjendje t'i ndihmoni ata për shkak të punësimit, shëndetit të dëmtuar dhe pleqërisë.

## ASISTENCA PERSONALE

Ky shërbim përfshin ndihmë dhe mbështetje individuale për personat e moshës 18 deri në 65 vjeç, me aftësi funksionale të zvogëluar, për t'u mundësuar jetesë të pavarur dhe individuale, pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në komunitetin, si dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme, të cilat një person pa aftësi të kufizuara zakonisht i kryen pa mbështetje. Asistenca personale përfshin: ndihmë dhe mbështetje në kryerjen e veprimtarive bazike dhe instrumentale të jetës së përditshme, ndihmë dhe mbështetje në vendin e punës, institucionet arsimore, qendrat e rehabilitimit, ndihmë dhe mbështetje në komunitetin dhe aktivitete të tjera të interesit personal, deri në 80 orë në muaj.

---

**Përdoruesit e shërbimit** janë njerëz me aftësi të kufizuara fizike nga më të rëndat dhe aftësi të kombinuara të shkallës më të lartë, njerëz plotësisht të verbër, pleq dhe njerëz të tjerë të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes në shtëpi.

Këtë shërbim mund ta përdorin fëmijët me aftësi të kufizuara, nëse ju si prindër nuk jeni në gjendje t'i ndihmoni ata për shkak të punësimit, shëndetit të dëmtuar dhe pleqërisë.

## Cilat janë shërbimet sociale në komunitetin?

- **Shërbimi i akomodimit ditor** i përfshin kujdesin ditor, aktivitetet individuale për përvetësimin e aftësive të jetës dhe të punës, aktivitetet sociale, kulturore dhe rekreative, arsimin, mbështetjen sociale të personave dhe familjeve të tyre dhe aktiviteteve të tjera të lidhura.
- **Shërbimi për rehabilitimin dhe riintegrimin** e personave që përballen me probleme sociale dhe/ose shëndetësore sigurohet përmes mbështetjes psiko-sociale, punës terapeutike, terapisë profesionale, mbështetjes për përvetësimin e aftësive të punës dhe aftësive për punësim, riintegrim dhe jetesë të pavarur.
- **Shërbimi për përkujdesje familjare** ofron kujdes afatshkurtër për anëtarët e varur të familjes me qëllim zëvendësimin, pushimin dhe plotësimin e nevojave personale dhe profesionale të anëtarëve të familjes që kujdesen për to. Ky shërbim mund të ofrohet gjithashtu në shtëpinë e përdoruesit. Kostoja e këtij shërbimi rimbursohet nga qendrat për punë sociale dhe sigurohet me kohëzgjatje deri në 15 ditë gjatë një viti kalendarik

---

Për shkak të komplikimeve të rënda gjatë një operacioni, gjendja shëndetësore e Leilas është dëmtuar përgjithmonë që do të thotë se ajo ka paaftësi të përhershme fizike dhe intelektuale. Si rezultat i kësaj, ajo nuk mund të punojë, as nuk mund të kujdeset për veten dhe t'i kryejë aktivitetet e saj të përditshme. Edhe pse gjendja e saj shëndetësore është përkëqësuar për gjithë jetën, një ekip nga Qendra për Punë Sociale i kërkon Leilës ta paraqesë dokumentacionin çdo vit dhe të paraqitet në një kontroll mjekësor për të përcaktuar nëse ajo ende ka nevojë për të drejtën e kompensimit për aftësinë e kufizuar.

*Personi që ka, ose për të cilin ekziston mundësia që gjendja e tij/saj shëndetësore të ndryshojë, duhet ta paraqesë dokumentacionin ose të paraqitet në një kontroll mjekësor, në një interval të caktuar kohor, në mënyrë që të mund ta ushtrijë të drejtën e tij/saj për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale. Kërkesat e institucioneve që personi i cili ka dëmtime të përhershme të gjendjes shëndetësore t'i nënshtrohet të njëjtës procedurë si personat e tjerë, e vendos në një pozitë më të pafavorshme nga të tjerët dhe kjo quhet diskriminim.*



## ARSIMI

### Ndryshimet në Ligjin për arsimin fillor

Ligji i ri për arsimin fillor, i miratuar në gusht 2019, e promovon gjithëpërfshirjen e arsimit për të gjithë fëmijët, përmes formave të ndryshme të mbështetjes së nxënësve me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen nga diskriminimi në procesin arsimor.

**Ligji filloi të zbatohet në shtator, me fillimin e vitit shkollor 2019/2020, kurse miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e tij është duke u zhvilluar.**

## Cilët janë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore?

- Nxënësit me aftësi të kufizuara,
- Nxënësit me nevoja të ndërlikuara emocionale ose që kanë nevojë për ndihmë me metodat konvencionale të të mësuarit, dhe
- Nxënësit me origjinë nga mjediset e pafavorshme socio-ekonomike, kulturore dhe/ose gjuhësore të privuara

## NDALIMI I DISKRIMINIMIT

**Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në arsimin fillor, inicimi dhe inkurajimi i diskriminimit dhe mbështetja e sjelljes diskriminuese në çfarëdo baze, duke i përfshirë dhe aftësitë e kufizuara**

---

*Ndalimi i diskriminimit të përfshin edhe ty si prind ose kujdestar i nxënësit, për cilindo prej arsyeve.*

I gjithë personeli shkollor është i detyruar të promovojë barazi dhe drejtësi midis të gjithë nxënësit dhe t'i kundërshtojë të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës.

## Adaptimi i arsyeshëm në arsimin

**Infrastruktura, plani arsimor dhe programi në arsimin fillor dhe i gjithë procesi arsimor duhet të ndryshohen dhe përshtaten për nxënësit me aftësi të kufizuara**, në mënyrë në të cilën nuk do të shkaktojë ngarkesë joproporcionale ose të panevojshme për shkollën. Gjithashtu duhet të merren masa për të siguruar që nxënësit me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë në ndërtesën e shkollës dhe klasat, transportin, informacionet, përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit në shkollë.



## Shkolla gjithashtu mund të sigurojë mbështetje mësimore për nxënësit me aftësi të kufizuara në formën e:

- një asistenti arsimor,
- një asistenti personal,
- mbështetje të përshtatshme profesionale nga një qendër për mbështetje arsimore,
- një ekipi inkluziv, dhe
- teknologji ndihmëse.

**Asistentët arsimorë dhe personalë** punësohen për një periudhë të caktuar kohore nga shkollat me një qendër të resurseve. Në rast se komuna nuk ka shkollë fillore me qendër burimesh ose qendër mbështetëse, kjo mbështetje duhet të ofrohet nga shkolla fillore më e afërt me një qendër të resurseve ose një qendër për mbështetje nga komuna më e afërt.

### KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

si një shoqatë e autorizuar për ndihmë juridike falas mund të të ndihmojë të mësosh më shumë për të drejtat në fushën e arsimit dhe të të ndihmojë ta mbrosh veten nëse gëzimi i ndonjë prej të drejtave të tua të është çmundësuar.

#### Adresa jonë është

rr. „Naum Naumovski Borçe” nr. 83 1000 Shkup

#### Mund të na kontaktosh edhe në numrat e telefonit

+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436  
ose me email [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

Emini është një fëmijë që ka pengesa në të folur, por pavarësisht kësaj, ai shkon në shkollë fillore me shumë dëshirë dhe përkushtim. Në moshën vetëm 7 vjeç, ai u përball me frikën më të madhe - të mos pranohej nga rrethi. Këtë herë ishin mësuesi i tij i klasës, pedagogu dhe psikologu i shkollës, ata, që përtej mungesës së ekspertizës së duhur në atë fushë, insistuan që Emini të çregjistrohet nga shkolla për shkak se është „i sëmurë“ nga autizmi.

***Në arsimin fillor ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, inicim dhe inkurajim i diskriminimit dhe mbështetja e sjelljes diskriminuese në çfarëdo baze. Punonjësit e shkollave fillore janë të detyruar të promovojnë barazi dhe drejtësi midis të gjithë nxënësve dhe t'i kundërshtojnë në mënyrë aktive të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës.***



## MARRËDHËNIET NË PUNË

Punëdhënësi **nuk guxon të ta anulojë kontratën e punës** kur je duke punuar me **kohë të pjesshme për shkak të kujdesit të fëmijëve me probleme zhvillimore dhe nevoja të veçanta arsimore.**

Si prind i një fëmije me probleme zhvillimore dhe nevoja të veçanta arsimore, ti ke të drejtë të punosh gjysmen e kohës së plotë, sikur të punosh me kohë të plotë. Këtë të drejtë mund ta përdorësh nëse je prind i vetëm ose nëse ti dhe prindi tjetër jeni të punësuar, në mënyrë që njëri prind të jetë përdorues i kësaj të drejte.

---

Këtë të drejtë mund ta përdorësh vetëm nëse fëmija nuk është vendosur në një institucion të kujdesit shoqëror-shëndetsor.

***E drejta për kompensim pagash*** (shpjegohet më në detaje në faqen 19 të kësaj broshure) paguhet sipas rregullave për mbrojtjen sociale

# NËSE KE NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE

*ose informacione juridike, këshilla në lidhje me përdorimin e të drejtës për të punuar me kohë të pjesshme ose ke nevojë për ndihmë për mbrojtje, kur kjo e drejtë të është shkelur, ti mund të drejtohesh në*

## Komitetin e Helsinki për të Drejtat e Njeriut

rr. „Naum Naumovski  
Borçe” nr 83 në Shkup

Mund të na kontaktosh  
edhe në numrat e  
telefonit

**+389 (0) 2 3119 073;**  
**+389 (0) 72 278 436**  
ose me email  
**helkom@mhc.org.mk**

Zorica është prind i një fëmije me një kombinim të aftësive të kufizuara, pra me aftësi të lehtë të kufizuara intelektuale dhe sindromë autike, e punësuar në një supermarket. Ajo ka aplikuar tek punëdhënësi një kërkesë për punë me kohë të pjesshme. Përkatësisht, si prind i një fëmije me probleme zhvillimore dhe nevoja të veçanta arsimore, punëtorja ka të drejtë të punojë gjysmën e kohës së plotë, dhe në këtë rast puna me kohë të pjesshme konsiderohet me kohë të plotë. Punëdhënësi i është përgjigjur me refuzim të kërkesës së saj.

**Ligji për marrëdhëniet e punës i vendos prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në grupin e punëtorëve për të cilët sigurohet mbrojtje e veçantë (Kapitulli XII i Ligjit). Përkatësisht, ndalimi i diskriminimit nuk kufizohet vetëm tek personat me aftësi të kufizuara, por i përfshin edhe personat e prekur nga gjendja e tyre, përkatësisht anëtarët e familjes, kujdestarët dhe personat e tjerë që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara.**

**KU MUND TË RAPORTOSH**

**DISKRIMINIM DHE**

**SHKELJE TË TË DREJTAVE**

### **Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**

rr. „Naum Naumovski Borçe” nr 83 në Shkup

telefon për kontakt: + 389 (0) 2 3119 073

+ 389 (0) 72 278 436

email: [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

### **Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Ankesa dorëzohet në faqen e internetit [www.kzd.mk](http://www.kzd.mk) ose me shkrim në adresën e Komisionit „Kej Dimirat Vlahov” p.n. Shkup

### **Avokati i popullit**

Ankesa dorëzohet me shkrim (personalisht ose me postë) në adresën rr. „Makedonija”, nr. 19 Shkup, gojarisht në procesverbalet në ambientet e avokatit të popullit, në numrin e telefonit: **+ 389 (0) 02 3129 335** ose me email në: [contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk).

## Zyrat rajonale dhe personat e autorizuar e

### Ministrisë së Drejtësisë

<b>BEROVË</b>	LJUPKA DUPKARSKA	071 205 324
	ljdupkarska@mjustice.gov.mk	
<b>MANASTIR</b>	MIRJANA RUTESKA	071 223 392
	mruteska@mjustice.gov.mk	
<b>MAKEDONSKI BROD</b>	VLADO KRSTESKI	071 223 075
	IVICA DIMOSKI	078 640 786
<b>VINICË</b>	GORANÇO DIMITROV	071 213 964
	gdimitrov@mjustice.gov.mk	
<b>VALLANDOVË</b>	FIKA KABUROVA	071 213 925
	fkaburova@mjustice.gov.mk	
<b>GJEVGJELI</b>	SUZANA SHUTEVA	071 224 678
	MITE PEEV	071 216 267
<b>GOSTIVAR</b>	ADEM OSMANI	071 223 180
	aosmani@mjustice.gov.mk	
<b>DIBËR</b>	TONI KOLECI	071 223 768
	tkoleci@mjustice.gov.mk	
<b>DELLÇEVË</b>	GORAN STOIMENOVSKI	071 283 948
	gstoimenovski@mjustice.gov.mk	
<b>DEMIR HISAR</b>	ANETA MITRAJÇEVSKA	075 766 695
<b>KAVADAR</b>	CVETANKA	075 659 855
	BASHTOVANOVA	
<b>KËRÇOVË</b>	ANETA MITRAJÇEVSKA	071 224 652
<b>KOÇAN</b>	MAGDAENA MANÇEVA	071 221 580
<b>KRIVA PALLANKA</b>	SUZANA ILIEVSKA	071 224 580
	silievska@mjustice.gov.mk	
<b>KRUSHEVË</b>	OLLGA STOJÇEVSKA	071 227 808
	ostojceska@mjustice.gov.mk	

<b>KUMANOVË</b>	<b>FROSINA STEFANOVIQ</b>	<b>071 227 962</b> fstevanovic@mjustice.gov.mk
<b>NEGOTINË</b>	<b>JOVANKA KAMÇEVA</b>	<b>071 223 191</b> jkamceva@mjustice.gov.mk
<b>OHËR</b>	<b>TONI KOÇESKI</b>	<b>071 221 908</b> tkoceski@mjustice.gov.mk
<b>PRILEP</b>	<b>ANTONIO SIMONOSKI</b>	<b>076 232 886</b>
<b>PROBISHTIP</b>	<b>MARTIN MLADENOVSKI</b>	<b>078 330 434</b>
<b>RADOVISH</b>	<b>DANIELA SVIRKOVA</b>	<b>070 261 310</b>
<b>RESNJË</b>	<b>DIVNA BARANDOVSKA</b>	<b>071 221 246</b> dbarandovska@mjustice.gov.mk
<b>SVETI NIKOLLË</b>	<b>GORDAN MILLANOV</b>	<b>071 227 862</b> gmlanov@mjustice.gov.mk
<b>STRUGË</b>	<b>SEVIMA SALIEVSKA</b>	<b>071 223 015</b> sevimasalievaska@mjustice.gov.mk
<b>STRUMICË</b>	<b>MILLKA VELLKOVA KLESOVA</b>	<b>071 224 526</b>
<b>TETOVË</b>	<b>EMINE ZEJNELI</b>	<b>071 227 893</b> ezejneli@mjustice.gov.mk
<b>SHTIP</b>	<b>MARIKA DELEVA</b>	<b>071 221 484</b> marikadeleva@mjustice.gov.mk
<b>KARPOSH</b>	<b>VENERA VASILEVSKA</b>	<b>071 221 381</b> vvasileska@mjustice.gov.mk
<b>QENDËR</b>	<b>ZURIJA MEMEDOVA</b>	<b>078 442 006</b>
<b>KISELLA VODË</b>	<b>ZORICA STANKOVIQ</b>	<b>071 224 104</b> ezejneli@mjustice.gov.mk
<b>GAZI BABË</b>	<b>REMZI BEQIRI</b>	<b>071 213 798</b> zstankovic@mjustice.gov.mk



British Embassy  
Skopje



**UKaid**  
from the British people



KOMITETI I  
HELSINKIT PËR  
TË DREJTAT E  
NJERIUT

unicef 